

REPUBLIKA E SHQIPERISE

DHOMA E NOTERISE FIER

NOTERE PUBLIKE Minella Milo

Nr. 3123 REP. Nr. — KOL!

KONTRATE E SHITJES SE KUOTES

Sot me dt. 19 Shtator 1998, ne zyren e noterise Fier, para meje noteres Minella Milo, u paraqiten personalisht palet kontraktuese te cilat kerkuan redaktimin e kontrates se shitjes se kuotes me kete permbajtje:

S H I T E S I: Gjysho Sherifi i biri i Fetiut, dt. lindje 6 Prill 1956, lindur dhe banues ne Fier, madhor, me zotesi te plote per te vepruar, i panjohur prej meje dhe i identifikuar nepermjete leternjoftimit te tij personal me Nr. EV 465735 te cilen e kishte me vete.

B L E R E S I T: Et'hem Aliaj i biri i Izeirit dt. lindje 1951, lindur ne Ballesh dhe banues ne Fier, madhor, me zotesi te plote per te vepruar, i panjohur prej meje dhe i identifikuar nepermjete leternjoftimit te tij personal me Nr. NF 017123.

Bardhyl Hazizi i biri i Dine, dt. lindje 1955, lindur ne Ngraçan dhe banues ne Fier, madhor, me zotesi te plote per te vepruar, i panjohur prej meje dhe i identifikuar nepermjete leternjoftimit te tij personal me Nr.

O B J E K T I: Kontrate shitblerje e kuotes se kapitalit ne sh.p.k. "FYBEK".

Palet e mesiperme u moren vesh si me poshte:

Ne palet kontraktuese te kesaj kontrate jemi ortake te vetem te SH. P.K. "FYBEK", me pjesemarrje te kapitaleve ne kete shoqeri ne raportete: Une shitesi Gjysho Sherifi 33.3%, dhe bleresi Et'hem Aliaj 33.3% e Bardhyl Hazizi 33.3%. Kjo shoqeri eshte e regjistruar ne regjistrin themeltar tregetar te gjykates se rrethit Tirane me Nr. 16200 dt. 25.10.1996. Une shitesi Gjysho Sherfi pjesen time te kapitalit prej 33.3% ne kete shoqeri ne masen 33.300 leke (tridhjetë e tremije e treqind leke). Kete shume kapitali te shprehur ne perqindje dhe ne leke shitesi deklarone se ua shese ortakeve te tjere, bçeresave Et'hem Aliaj dhe Bardhyl Hazizi ne pjese te barabarta per sejcilin dhe qe nga ky moment une nuk kam asnje te drejte e detyrime ndaj shoqerise dhe te treteve.

Ne bleresit Et'hem Aliaj dhe Bardhyl Hazizaj deklarojme se eshte e vertete qe kemi blere prej shitesit Gjysho Sherifi, ortakut tjetër, gjithë kuoten e pjesemarrjes se tij ne kete shoqeri, koten prej 33.300 leke (tridhjetë e tremije e treqind leke) dhe qe nga ky moment ne bleresit jemi zoterues te te gjithë kapitalit, ne pjese te barabarta nga 50% sejcili dhe ne masen 50.000 leke (pesedhjetë mije leke) sejcili.